

# UNIVERSITETI “ISA BOLETINI” MITROVICË

## Fakulteti Ekonomik

**Programi:** Biznes dhe Menaxhment

(Specializim: Banka, Financa dhe Kontabilitet)



## PUNIM DIPLOME

**Student:**

Ahmet PEÇI

**Mentor:**

Prof. Asoc. Dr. Esat DURGUTI

# UNIVERSITETI “ISA BOLETINI” MITROVICË

## Fakulteti Ekonomik

**Programi:** Biznes dhe Menaxhment

(Specializim: Banka, Financa dhe Kontabilitet)



**Lënda:** Tregjet dhe Institucionet Financiare

**Tema:** Vlerësimi i performancës dhe kompenzimi i dëmeve në industrinë e sigurimeve – analizë rasti Kompania Siguria

**Student:**

Ahmet PEÇI

**Mentor:**

Prof. Asoc. Dr. Esat DURGUTI

**UNIVERSITY “ISA BOLETINI” MITROVICA**  
**FACULTY OF ECONOMICS**  
**DEPARTMENT: BUSINESS AND MANAGEMENT**  
**(SPECIALIZATION: BANKING, FINANCE AND ACCOUNTING)**



# **BACHELOR THESIS**

**PERFORMANCE ASSESSMENT AND DAMAGE COMPENSATION IN THE  
INSURANCE INDUSTRY – CASE ANALYSIS OF COMPANY SIGURIA**

**The candidate:**

Ahmet PEČI

**Mentor:**

Prof. Asoc.Dr. Esat DURGUTI

**UNIVERSITETI “ISA BOLETINI” MITROVICË**  
**FAKULTETI EKONOMIK**  
**PROGRAMI: BIZNES DHE MENAXHMENT**  
**(SPECIALIZIM: BANKA, FINANCA DHE KONTABILITET)**



## **PUNIM DIPLOME**

**Lënda:** Tregjet dhe Institucionet Financiare

**Titulli i punimit:** “Vlerësimi i performancës dhe kompensimi i dëmeve në industrinë e sigurimeve – analizë rasti Kompania Siguria”

**Emri dhe mbiemri:** Ahmet PEÇI

**Statusi i studentit:** I rregullt

**Numri i amzës (ID Regjistri):** 2005031087

**Niveli i studimeve:** Baçelor

**Programi:** Biznes dhe Menaxhment (Specializim: Banka, Financa dhe Kontabilitet)

**Programi i studimeve:** Biznes dhe Menaxhment (Specializim: Banka, Financa dhe Kontabilitet)

**Mentori i punimit:** Prof.Asoc.Dr. Esat DURGUTI

**Aprovuar prej komisionit:**

- \_\_\_\_\_ Mentor  
/Emri Mbiemri, Titulli /
- \_\_\_\_\_ Anëtar  
/Emri Mbiemri, Titulli /
- \_\_\_\_\_ Anëtar  
/Emri Mbiemri, Titulli /

Data e aprovimit: \_\_\_\_\_

## **FALENDERIME**

*Falenderimi i parë për çdo arritje i takon ZOTIT, për begatitë dhe mirësitë e pa numërta me të cilat më ka shpërblyer: shëndetin, familjen, mendjen e lumturinë.*

*Falenderim tejet i madh dhe shumë i veçantë shkon për familjen dhe posaqërisht për prindërit e mi. Ju faleminderit për dashurinë, mbështetjen dhe përkrahjen tuaj të pafund. Në çdo hap të kësaj rruge, keni qenë aty për mua, duke më inkurajuar dhe duke më besuar. Ju jeni burimi im i lumturisë dhe inspирimit.*

*Pjesë e rëndësishme e rrugëtimit tim akademik pa dyshim se kanë qenë dhe do mbeten gjithmonë kolegët e mi të cilët i falenderoj për miqësinë e mbështetjen. Falenderim i veçantë shkon për kolegen time Plotmirën, për inkurajimin për ndjekjen e studimeve, forcën, motivin dhe ndihmën e dhënë gjatë këtyre viteve, mbështetje kjo e e cila e bëri këtë zhvillim akademik timin më të lehtë e të sukseshëm.*

*Falenderoj Mentorin e temës sime të diplomës, i nderuari Prof.Asoc. Dr. Esat Durgutin, person ky i cili përveç ndihmesës, mentorimit, mbështetjes e këshillimit profesional, ka qenë ndër personat që më së shumti ka besuar e vlerësuar maksimalisht potencialin tim.*

*Në fund falenderoj gjithë stafin akademik për gatishmërinë, mirëkuptimin e profesionalizmin.*

*Të gjithë ju të lartë përmendur keni krijuar themelet e këtij suksesi të cilin e gëzojmë sot së bashku. Ju jam mirënjohës përjetë!*

## **DEKLARATA E ORIGJINALITETIT**

Ky punim diplome është punim original dhe nuk është dorëzuar, në tërësi apo pjesërisht, për ndonjë gradë në këtë apo ndonjë universitet tjetër. Dhe nuk përmbanë, sipas njohurisë sonë, asnjë material të botuar ose shkruar nga një person tjetër, përveç siç deklarohet në brendi të tekstit.

## **STATEMENT OF ORIGINALITY**

This thesis is our original work and has not been submitted, in whole or in part, for a degree at this or any other university. Nor does it contain, to the best of our knowledge and belief, any material published or written by another person, except as acknowledged in the text.

Emri/Name

Nënshkrimi/Signature

Data/Date

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

## Përmbajtja

Lista e tabelave .....	8
Lista e figurave .....	8
Lista e shkurtesave .....	8
ABSTRAKT .....	9
ABSTRACT.....	10
<b>Hyrje</b> .....	11
Paraqitja e problemit .....	12
<b>Metodologjia</b> .....	13
Mbledhja e të dhënave .....	14
Përpunimi i të dhënave.....	14
<b>1. Zanafilla e sigurimeve</b> .....	15
1.2 Historiku i sigurimeve në tregun kosovar .....	15
1.3 Kompanitë e sigurimeve në Kosovë .....	16
1.4 Llojet e sigurimeve në Kosovë.....	18
1.4.1 Sigurimi nga autopërgjegjësia.....	18
1.4.2 Sigurimi i pasurisë dhe pronës .....	18
1.4.3 Sigurimi shëndetsor.....	19
1.4.4 Sigurimi nga aksidentet personale .....	20
1.4.5 Sigurimi i udhëtimit .....	20
1.4.6 Sigurimi i jetës .....	20
<b>1.5 Byroja Kosovare e Sigurimit</b> .....	21
<b>2. Zanafilla e zhvillimit të Kompanisë së Sigurimit – Siguria</b> .....	22
2.1 Produktet të cilat ofrohen nga kompania .....	22
2.2 Objektivat e kompanisë.....	23
2.3 Treguesit e performancës .....	24
2.4 Kompensimi i dëmeve .....	25
2.5 Struktura e kapitalit.....	26
<b>3. Metodologjia e analizës empirike</b> .....	27
3.1 Përshkrimi i të dhënave.....	27
3.2 Statistikat përshkruese .....	27

3.3 Analiza e korrelacionit.....	28
3.4 Analiza e regresionit .....	30
<b>Rekomandime.....</b>	<b>34</b>
Referenca .....	35

## Lista e tabelave

Tabela 1. Kompensimi i dëmeve ndër vite .....	25
Tabela 2. Struktura e kapitalit e kompanisë SIGURIA.....	26
Tabela 3. Statistikat përshkruese .....	28
Tabela 4. Analiza e korrelacionit – ROA.....	29
Tabela 5. Analiza e korrelacionit - ROE.....	29
Tabela 6. Analiza e regresionit – ROA.....	30
Tabela 7. Analiza e regresionit – ROE .....	31

## Lista e figurave

Figura 1. Treguesit e kthimit në ROA dhe ROE.....	24
---	----

## Lista e shkurtesave

BKS – Byroja Kosovare e Sigurimit

BQK – Banka Qëndrore e Kosovës

UNMIK – United Nations Mission in Kosovo (Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë)

ROA – Kthimi në asete

ROE – Kthimi në kapital



## ABSTRAKT

*Ky punim diplome i nivelit bachelor analizon vlerësimin e performancës dhe kompensimin e dëmeve në industrinë e sigurimeve. Për këtë qëllim, punimi përfshin një analizë të faktorëve të ndryshëm që ndikojnë në performancën financiare të kompanive të sigurimeve, përfshirë variablat e varur kthimi në asete dhe kthimi në ekuitet, ndërsa variablat të pavarura si raporti i dëmeve të ndodhura neto, raporti i shpenzimeve neto, raporti i mbulueshmërisë së provizioneve teknike dhe raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit.*

*Po ashtu, është analizuar mënyra se si kompanitë e sigurimeve kompensojnë dëmet ndaj klientëve dhe sa efektive janë në këtë proces. Kjo analizë është e bazuar në të dhënat financiare të kompanisë (të dhënat janë sekondare duke e përfshirë periudhën 2016-2022) së sigurimit SIGURIA, me përdorimin e modeleve të analizave statistikore. Rezultatet e këtij punimi do të ndihmojnë në kuptimin e më mirë të performancës financiare në industrinë e sigurimeve dhe në identifikimin e praktikave më të mira për kompensimin e dëmeve.*

*Ky informacion është i rëndësishëm për kompanitë e sigurimeve, rregulatorët dhe klientët në industrinë e sigurimeve dhe ndihmon në përmirësimin e qëndrueshmërisë dhe transparencës në këtë sektor të rëndësishëm financiar.*

**Fjalët kyqe:** *Kompani e sigurimeve, asetet rrjedhëse, performancë, ROA, ROE.*

## ABSTRACT

*This bachelor's thesis examines the evaluation of performance and claims compensation in the insurance industry. For this purpose, the thesis includes an analysis of various factors that impact the financial performance of insurance companies, including dependent variables like return on assets and return on equity, while independent variables include the net incurred loss ratio, net expense ratio, adequacy of technical provisions, and capital adequacy ratio.*

*Additionally, it analyzes how insurance companies compensate for claims and how efficient they are in this process. This analysis is based on financial data from SIGURIA insurance company (the data is secondary and covers the period from 2016 to 2022) and utilizes statistical analysis models. The results of this thesis will contribute to a better understanding of financial performance in the insurance industry and identify best practices for claims compensation.*

*This information is crucial for insurance companies, regulators, and clients in the insurance industry and aids in improving sustainability and transparency in this vital financial sector*

**Keywords:** *Insurance company, current assets, performance, ROA, ROE.*

## Hyrje

Vlerësimi i performancës dhe kompenzimi i dëmeve në industrinë e sigurimeve është një temë e rëndësishme dhe komplekse që ka ndikim të drejtpërdrejtë në mënyrën se si kompanitë e sigurimeve operojnë dhe si ata menaxhojnë rreziqet financiare. Menaxhimi i tyre i suksesshëm është kyç për qëndrueshmërinë dhe suksesin e kompanive të sigurimeve në një treg të ndryshueshëm dhe konkurrues.

Industria e sigurimeve është një sektor i rëndësishëm në ekonominë globale, duke luajtur një rol kyç në mbrojtjen financiare të individëve dhe bizneseve nga rreziqet e ndryshme. Në këtë sektor, vlerësimi i performancës është një proces thelbësor që përdoret për të vlerësuar efikasitetin dhe aftësinë e kompanive të sigurimeve për të përmbushur detyrimet e tyre ndaj klientëve dhe investitorëve.

Vlerësimi i performancës në industrinë e sigurimeve përfshin një gamë të gjerë të elementeve dhe metodave të përdorura për të analizuar dhe vlerësuar performancën e një kompanie të sigurimeve (Dwivedi *et al.* 2021). Kjo përfshin monitorimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të kompanisë, efikasitetin e proceseve të saj të administratës dhe menaxhimit të rreziqeve, si dhe aftësinë e saj për të menaxhuar dëmet dhe pagesat ndaj klientëve. Gjithashtu, vlerësimi i performancës shikon edhe shërbimin ndaj klientëve dhe aftësinë e kompanisë për të mbajtur premtimet e tyre të sigurimit.

Ky proces është thelbësor për dy kategoritë kryesore: klientët dhe investitorët. Për klientët, një kompani e sigurimeve me një performancë të mirë do të ofrojë një përvojë më të mirë të sigurimit, përfshirë pagesa të shpejta dhe të drejta për dëmet e tyre. Për investitorët, vlerësimi i performancës është një mjet për të vlerësuar stabilitetin financiar të kompanisë dhe aftësinë e saj për të ofruar përfitime të volitshme në formën e dividendëve dhe rritjes së çmimit të aksioneve.

Përveç kësaj, vlerësimi i performancës ndihmon në konkurrencën në tregun e sigurimeve. Kompanitë që mund të tregojnë një performancë të shkëlqyer janë më të lira për të tërhequr klientë të rinj dhe për të rritur pjesën e tyre në tregun e sigurimeve (Khalaf & Nobanee, 2022). Kjo i bën ato më të qëndrueshme dhe të përshtatshme për të përbaluar sfidat që vijnë nga konkurrenca e fortë në këtë sektor.

Megjithatë, vlerësimi i performancës në industrinë e sigurimeve nuk është një detyrë e thjeshtë. Kjo industri përballlet me rreziqe të shumta, të tilla si dëmet e papritura nga fatkeqësitë natyrore, që mund

të kenë një ndikim të madh në situatën financiare të një kompanie. Për këtë arsye, teknikat dhe metodat për vlerësimin e performancës janë të ndryshueshme dhe të sofistikuara. Ata përfshijnë analizën e të dhënave financiare, vlerësimin e rreziqeve potenciale dhe monitorimin e tregut të sigurimeve.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është kompenzimi i dëmeve. Ky është një proces i ndërlikuar që përfshin vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga ngjarje të ndryshme, si aksidentet automobilistike, fatkeqësitë natyrore dhe dëmet e tjera të mbuluara nga polica e sigurimit. Për të siguruar që klientët marrin kompensim të drejtë për dëmet e tyre, kompanitë e sigurimeve duhet të kenë sisteme të avancuara për vlerësimin e dëmeve dhe për të zbatuar rregullat dhe politikat e tyre me saktësi.

Gjithashtu, kompenzimi i dëmeve ka një ndikim të drejtpërdrejtë në performancën financiare të kompanive të sigurimeve. Ata duhet të jenë të afta të menaxhojnë riskun financiar dhe të sigurojnë që ata kanë burime të mjaftueshme për të paguar kompensimin e dëmeve në kohë. Kjo përfshin strategji të përcaktimit të tarifave dhe investimet e tyre në instrumente financiare.

Fillimisht në kapitullin e parë diskutohet historiku i industrisë së sigurimeve, kapitulli i dytë përshkruan kompaninë e sigurimit SIGURIA, më pas në kapitullin e tretë përmbledhim të gjeturat dhe diskutojmë mbi analizën empirike dhe në fund kapitulli i katërt përfshinë konkluzionet dhe rekomandimet.

## **Paraqitja e problemit**

Për të analizuar një dukuri në aspektin empirik është e domosdoshme që të bëhet formulimi i problemit, në formë të pyetjeve kërkimore. Nga ky këndvështrim punimi i diplomës nëpërmjet disa pyetjeve kërkimore formëson bazamentin kryesor të hulumtimit, dhe si rrjedhojë krijon bazën për formulimin e hipotezave.

Pyetjet kërkimore të këtij punimi janë si vijon:

***Pyetja kërkimore 1:*** Si reflektohet menaxhimi i raportit të dëmeve të ndodhura neto dhe raporti i mbulueshmërisë së rezervave teknike në profitabilitetin (kthimi në asete dhe kthimi në ekuitet) e Kompanisë së Sigurimeve – Siguria?

**Pyetja kërkimore 2:** Çfarë ndikimi mund të kenë raporti i shpenzimeve të përgjithshme neto në profitabilitetin (kthimi në asete dhe kthimi në ekuitet) e Kompanisë së Sigurimeve – Siguria?

**Pyetja kërkimore 3:** Cila është ndërlidhja ndërmjet mjaftueshmërisë së kapitalit dhe profitabilitetit?

Në bazë të pyetjeve kërkimore, kemi parashtruar hipotezat:

**H<sub>1</sub>:** Raporti i dëmeve të ndodhura neto ka ndikim negativ në raportin e kthimit në asete në Kompaninë e Sigurimeve – SIGURIA.

**H<sub>2</sub>:** Raporti i mbulueshmërisë së provizioneve teknike ka ndikim negativ në raportin e kthimit në asete në Kompaninë e Sigurimeve – SIGURIA.

**H<sub>3</sub>:** Raporti i dëmeve të ndodhura neto ka ndikim pozitiv në raportin e kthimit në kapital në Kompaninë e Sigurimeve – SIGURIA.

**H<sub>4</sub>:** Raporti i mbulueshmërisë së provizioneve teknike ka ndikim pozitiv në raportin e kthimit në kapital në Kompaninë e Sigurimeve – SIGURIA.

**H<sub>5</sub>:** Raporti i shpenzimeve neto ka një ndikim pozitiv në raportin e kthimit në asete në Kompaninë e Sigurimeve – SIGURIA.

**H<sub>6</sub>:** Raporti i shpenzimeve neto ka një ndikim negativ në raportin e kthimit në kapita në Kompaninë e Sigurimeve – SIGURIA.

**H<sub>7</sub>:** Ndërlidhja ndërmjet mjaftueshmërisë së kapitalit dhe kthimit në asete është pozitive në Kompaninë e Sigurimeve – SIGURIA.

**H<sub>8</sub>:** Ndërlidhja ndërmjet mjaftueshmërisë së kapitalit dhe kthimit në kapital është negative në Kompaninë e Sigurimeve – SIGURIA.

## **Metodologjia**

Ky punim diplome synon vlerësimin e performancës dhe kompenzimin e dëmeve në industrinë e sigurimeve duke marrë rast studimi kompaninë e sigurimit SIGURIA, me 7 observime duke përfshirë periudhën kohore 2016-2022. Në këtë punim prioritet më të madh kanë dy variablat e varura a) kthimi në asete dhe b) kthimi në ekuitet por gjithashtu ky punim përfshin edhe variablat tjera të

pavarura si a) raporti i dëmeve të ndodhura neto, b) raporti i shpenzimeve neto, c) raporti i mbulueshmërisë së provizioneve teknike, d) raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit.

Për më tepër, në këtë punim janë aplikuar edhe analiza të korrelacionit dhe regresionit duke përfshirë teste diagnostifikuese për të vlerësuar shkallën e ndikimit. Gjithë burimet e përdorura janë burime të besueshme dhe serioze.

## **Mbledhja e të dhënave**

Të dhënat e përdorura në këtë punim diplome janë të dhëna sekondare, të shprehura në baza vjetore me gjithsej 7 observime. Këto të dhënat janë siguruar nga webfaqja zyrtare e kompanisë së sigurimit SIGURIA (<https://ks-siguria.com/siguria/kompania/>). Arsyeja e mos përfshirjes së periudhave të më hershme qëndron në atë se disa variablat nuk posedonin të dhënat adekuate.

Variablat e përfshira janë:

- Kthimi në asete,
- Kthimi në ekuitet,
- Raporti i dëmeve të ndodhura neto,
- Raporti i shpenzimeve neto,
- Raporti i mbulueshmërisë së provizioneve teknike,
- Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit.

## **Përpunimi i të dhënave**

Me që të dhënat janë nxjerrë nga webfaqja zyrtare e kompanisë së sigurimit SIGURIA, më pas ato janë organizuar dhe përshtatur për procesimin e mëtejshëm, në përputhje me qëllimet dhe hipotezat të paraqitura. Po ashtu, ato janë verifikuar për të vërtetuar hipotezat e parashtruara. Për analizën dhe trajtimin e këtyre të dhënave, është përdorur programi statistikor STATA, nga ku janë nxjerrë dhe prezantuar analizat e mëposhtme:

- Statistikat përshkruese,
- Analiza e korrelacionit,
- Analiza e regresionit të shumfishtë – OLS.

---

# KAPITULLI I PARË: HISTORIKU I ZHVILLIMIT TË INDUSTRIË SË SIGURIMIT

---

## 1. Zanafilla e sigurimeve

Kohë para Krishterimit, rreth Detit Mesdhe, tregtarët fenikasë tregtonin mallra dhe grurë dhe ishin pa dyshim të angazhuar në praktika të ngjarjeve të menaxhimit të rreziqeve. Pasiguria në lidhje me anijet e ngarkuara me grurë mund të sillte një humbje të madhe për tregtarët, edhe nëse ata tashmë kishin shpërndarë ngarkesën e tyre në disa anije. Ata arritën me një ide të re. Nëse çdo tregtar do të pajtohej të linte një pjesë të ngarkesës së grurit pranë kejdive<sup>1</sup> nga çdo anije, kjo do të përbënte një stok gruri që mund të përdorej për të kompensuar disa tregtarë në rast të humbjes së tërë ngarkesës.

Ata angazhuan një person për të mbrojtur grurin, i cili shpejt zbuloi se duke mbjellë grurin mund të zëvendësonte ngarkesën dhe të fitonte disa fitime. Tregtarët shpejt e kuptuan se sa më shumë të ishin në numër, aq më pak kishte nevojë të ndanin nga ngarkesa e secilës anije. Ata u pajtuan gjithashtu se tregtari i cili, ngarkesa e tij shkonte më larg kishte më shumë risk, dhe shtuan edhe disa kritere të tjera si mosha e anijes, përvoja e kapitenit, kritere të cilat mund të zvogëlonin ose rrisnin rrezikun. Ata angazhuan një njeri tjetër për të vlerësuar shkaqet e humbjeve dhe kështu filloi idea e sigurimeve (Outreville, 1998).

### 1.2 Historiku i sigurimeve në tregun kosovar

Në ish-Federatën Jugosllave, në krahasim me shumë shtete socialiste, kishte një sistem ekonomik dhe financiar më të avancuar. Ekonomia ishte përqendruar në tregun ekonomik, veçanërisht në Republikat e veriut. Megjithatë, pas shpërbërjes së Federatës Jugosllave, Republika e Bosnjës dhe Hercegovinës, Kosova dhe Republika e Kroacisë pësuan dëme të mëdha. Në vitet '90, në Kosovë nisi shkatërrimi total i sistemit financiar, dhe me luftën ky sistem u shkatërrua krejtësisht. Shumë punonjës u larguan nga puna, shumë njerëz u bënë punëkërkues, dhe hiperinflacioni i vitit 1993, së

---

<sup>1</sup> Term i vjetër i përdorur në kontekstin e tregtarisë detare, që nënkupton vendin ku tregtarët vendosnin grurin.

bashku me mungesën e sigurimeve sociale, solli migracion të madh të popullsisë drejt vendeve të perëndimit (Berisha, 2014).

Gjatë luftës, u shkatërrua sistemi ekonomik dhe financiar i Kosovës, i është sekuestruar pasuria qytetarëve, fabrikat u shkatërruan, dhe një numër i madh i popullsisë u zhvendos brenda dhe jashtë Kosovës. Megjithatë, pas luftës, shumica e popullatës u kthye dhe filoi rindërtimin e vendit me kapacitetet që kishin. UNMIK, në bashkëpunim me organet e përkohshme të Kosovës, filloi të krijojë bazat e shtetit të Kosovës. Me mungesën e organeve legjislative dhe kompetencave për miratimin e ligjeve, UNMIK aplikoi rregulla në bazë të cilave do të operonte shteti. Fillimisht, si monedhë e këmbimit përdoren valutat e ndryshme, me markën gjermane si monedha dominuese. Megjithatë, më vonë UNMIK vendosi që në Kosovë do të përdorej monedha e Bashkimit Evropian, euro. Kjo ndihmoi të vendoseshin bazat e sistemit financiar në Kosovë dhe sistemi financiar filloi të organizohet dhe të funksionojë si sistemi bankar.

Regjistrimin dhe licencimin e kompanive të sigurimeve në Kosovë e ka bërë UNMIK-u, shtylla e katërt në bashkëpunim me AQBK, në bazë të rregulloreve:

1. Rregullorja nr. 3 e UNMIK-u në vitin 1999,
2. Rregullorja nr. 15 e UNMIK-u në vitin 1999,
3. Ligji për sigurim-rregullorja e UNMIK-u 2001/25,
4. Ligji për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (04/L-093)
5. Ligji për Sigurime (05/L-045)
6. Ligji për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (04/L-018),
7. Ligji mbi falimentimin dhe likuidimin e bankave dhe kompanive të sigurimeve.

### **1.3 Kompanitë e sigurimeve në Kosovë**

Bazuar në dispozitat e nenit 35, paragrafi 1.1 të Ligjit numër 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës si dhe dispozitat e nenit 3.3 dhe nenit 12 të Rregullores numër 2001/25 lidhur me Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimeve dhe të Ndërmjetësuesve të Sigurimit, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për të licencuar një kompani të sigurimit kërkon përmbushjen e kritereve në vazhdim:



- a) Nëse plani i biznesit bazohet në analiza të sakta dhe në supozime të arsyeshme;
- b) Nëse struktura organizative e kompanisë së sigurimeve të propozuar apo degës së kompanisë së huaj të sigurimeve do t'i lejojë BQK-së të ushtrojë mbikëqyrje efektive dhe të konsoliduar;
- c) Primet e llogaritura dhe provizionet teknike/matematike janë të mjaftueshme dhe arsyetojnë mbulimin e aktiviteteve dhe rreziqeve të parapara të kompanisë së sigurimeve;
- d) Kompania e propozuar do të veprojë në pajtueshmëri me të gjitha dispozitat e Rregullores 2001/25 dhe akteve të tjera të brendshme ligjore;

Në vitin 2001, u krijua edhe Fondi i Garancisë sipas rregullores nr. 3 të Autoritetit të Sigurimeve të Kosovës. Ky fond ofron mbrojtje për të gjithë personat që janë të prekur nga dëmet që shkaktohen nga palë të treta të pasiguruar. Të gjitha kompanitë e sigurimeve janë të obliguara të kontribuojnë në këtë fond. Ky proces shënon rrugën e zhvillimit të sistemit financiar të Kosovës pas periudhës së konfliktit dhe ndihmon në kuptimin e ndryshimeve thelbësore që ka përjetuar ky vend në fushën financiare dhe të sigurimeve.

#### **Aktet e themelimit të kompanive të sigurimit:**

Marrëveshja për themelim,  
Projekt statuti,  
Emri i propozuar,  
Numri i aksionarëve nëse ka,  
Plani i biznesit,  
Struktura organizative.

Kompanitë e sigurimeve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Kosovë, të regjistruara në Byron Kosovare të Sigurimit janë:

- Kompania e Sigurimeve “Dukagjini”
- Kompania e Sigurimeve “Elsig”
- Kompania e Sigurimeve “Eurosig”
- Kompania e Sigurimeve “Illyria”
- Kompania e Sigurimeve “Prisig”
- Kompania e Sigurimeve “Scardian”
- Kompania e Sigurimeve “Sigal Uniq Group”

- Kompania e Sigurimeve “Sigkos”
- Kompania e Sigurimeve “Sigma Vienna Insurance Group”
- Kompania e Sigurimeve “Siguria”

## 1.4 Llojet e sigurimeve në Kosovë

### 1.4.1 Sigurimi nga autopërgjegjësia

Sigurimi nga autopërgjegjësia është një sigurim i rëndësishëm në jetën e përditshme, pasi automjetet janë pjesë e pandashme e shumë jetëve tona dhe zakonisht përfaqësojnë një vlerë të konsiderueshme financiare. Dëmet e mundshme të shkaktuara nga automjeti, qoftë edhe të vogla, mund të rezultojnë në një barrë financiare të papritur për pronarët e automjeteve, duke u rrezikuar stabilitetin financiar të tyre dhe planeve të ardhshme (Byroja Kosovare e Sigurimit).

Për këtë arsye, sigurimi nga autopërgjegjësia është një mjet i rëndësishëm për të mbrojtur pasurinë dhe financat tuaja. Me këtë lloj sigurimi, ju e bartni përgjegjësinë tuaj ndaj dëmeve eventuale të shkaktuara ndaj palëve të treta tek një kompani e sigurimeve. Kjo do të thotë që në rast të një aksidenti, kompania e sigurimeve do të jetë e detyruar të kompensojë dëmet e palëve të treta në vend të jush, nëse ju jeni fajtor për aksidentin. Palët e treta në këtë kontekst përfshijnë këmbësorët, personat në automjetin tjetër, bashkëudhëtarët në automjetin që e ka shkaktuar dëmin dhe ka qenë fajtor për të, dhe të gjithë ata që nuk janë përjashtuar nga kjo kategori sipas ligjit për sigurimin nga autopërgjegjësia.

Për rrjedhojë, është e rekomandueshme dhe e rëndësishme që të keni një sigurim të vlefshëm nga autopërgjegjësia. Ky lloj sigurimi është i detyrueshëm me ligj në Republikën e Kosovës, duke ju ofruar juve dhe të tjerëve një mbrojtje të nevojshme në rast të aksidenteve dhe dëmeve të mundshme të shkaktuara nga automjeti juaj.

### 1.4.2 Sigurimi i pasurisë dhe pronës

Sigurimi i pasurisë dhe pronës është një hap i rëndësishëm për të ruajtur dhe mbrojtur vlerat dhe pasurinë që kemi krijuar gjatë jetës sonë. Për shumë njerëz, blerja e një shtëpie ose hapja e një

biznesi është një arritje e madhe, por duhet të jemi të vetëdijshëm se ruajtja dhe mbrojtja e kësaj pasurie është po aq e rëndësishme sa krijimi i saj (Byroja Kosovare e Sigurimit).

Sigurimi i pasurisë dhe pronës ka për qëllim të kompensojë dëmet që mund të ndodhin në pasuri si pasojë e ngjarjeve të papritura, të paparashikueshme dhe aksidentale. Këto dëme mund të jenë shkatërrime nga zjarri, vjedhja, dëmtimet në mjete monetare, probleme inxhinjerie, dëme në mallin gjatë transportit, dhe shumë të tjera. Sigurimet e pasurisë janë një mjet i rëndësishëm për të ruajtur stabilitetin financiar, si për individët ashtu edhe për shoqërinë në përgjithësi. Ky lloj sigurimi mbulon:

- Sigurimi nga zjarri dhe rreziqet shtesë,
- Sigurimi nga vjedhja,
- Sigurimi i mjeteve monetare,
- Sigurimet inxhinjerie,
- Sigurimi i mallit në transport,
- Sigurimi i përgjegjësisë.

### **1.4.3 Sigurimi shëndetsor**

Sigurimi shëndetsor është një aspekt i rëndësishëm i mbrojtjes së shëndetit të individëve dhe familjeve. Ky lloj sigurimi është krijuar për të ndihmuar në përballimin e kostove të larta të mjekimit dhe trajtimit të sëmundjeve (Byroja Kosovare e Sigurimit).

Sigurimi shëndetsor ofrohet nga kompanitë e sigurimit dhe ka dy formate kryesore: sigurim individual dhe sigurim familjar. Sigurimi shëndetsor mbulon shpenzimet e tretmaneve mjekësore:

- Shpenzimet farmaceutike,
- Kujdesi parandalues,
- Trajtimet dentare,
- Trajtime të syve,
- Trajtime psikiatrike,
- Trajtime infermierie,
- Transporti.

#### **1.4.4 Sigurimi nga aksidentet personale**

Sigurimi nga aksidentet personale është një mjet i rëndësishëm për të mbrojtur veten nga pasojat e aksidenteve personale që ndodhin pa paralajmërim. Aksidentet personale mund të ndodhin në ndryshime të ndryshme kohe dhe vendesh, dhe ndonjëherë janë të pamundur të parandalohen. Qëllimi kryesor i këtij lloji të sigurimit është të ofrojë mbrojtje financiare në rast të një aksidenti që çon në vdekje ose paaftësi/invaliditet. Përfitimet e sigurimit nga aksidentet personale përfshijnë kompensimin e shpenzimeve mjekësore që rezultojnë nga trajtimi i nevojshëm pas një aksidenti personal. Ky sigurim mund të mbulojë kostot e spitalizimit, operacioneve, terapive, dhe kujdesit mjekësor të nevojshëm për të trajtuar dëmet e shkaktuara nga aksidenti (Byroja Kosovare e Sigurimit).

Sigurimi nga aksidentet personale mund të ofrojë edhe kompensim në rast të vdekjes aksidentale, duke paguar një shumë të caktuar të paracaktuar për të familjarët ose beneficiarët e personit të siguruar. Kjo është një mënyrë për të siguruar se pasuria dhe mirëqenia e familjes së personit të siguruar do të mbrohet në rast të ndodhjes së një aksidenti tragjik.

#### **1.4.5 Sigurimi i udhëtimit**

Ky lloj sigurimi, i njohur si sigurimi shëndetësor për udhëtime, është i dizajnuar për të ofruar mbrojtje në rast të sëmundjeve akute ose aksidenteve që ndodhin gjatë kohës së udhëtimit. Policat e sigurimit shëndetësor për udhëtime mbulojnë shpenzimet mjekësore që rezultojnë nga trajtimi i nevojshëm gjatë udhëtimit tuaj. Kjo mund të përfshijë konsultime mjekësore, spitalizim, operacione, dhe terapi të nevojshme për të trajtuar sëmundjen ose dëmin e shkaktuar nga aksidenti gjatë udhëtimit. Gjithashtu, ky lloj sigurimi ofron mbrojtje në rast të riatdhesimit në vendin e origjinës për trajtimin e vazhdueshëm të sëmundjes ose për të kryer funeralet në rast të vdekjes gjatë udhëtimit (Byroja Kosovare e Sigurimit).

#### **1.4.6 Sigurimi i jetës**

Polica e sigurimit të jetës është në thelb një mënyrë e investimit dhe kursimit për të ardhmen, e cila siguron përfitime të ndryshme për personin e siguruar dhe familjen e tij. Kjo është një mënyrë për të garantuar se në raste të ndryshme, si vdekja ose sëmundjet serioze, do të ketë një mbrojtje financiare në dispozicion.

## 1.5 Byroja Kosovare e Sigurimit

Byroja Kosovare e Sigurimit është një organizatë profesionale me status juridik të themeluar për qëllime jofitimprurëse. Veprimtarinë e saj e ushtron në bazë të Ligjit Nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës në Nr. 4 / 14 Korrik 2011 në Prishtinë.

Qeveria e Republikës së Kosovës njeht Byrojën Kosovare të Sigurimit si një institucion me statusin e Byrosë kombëtare të sigurimit me të drejta të pakufizuara në cilësi të Byrosë pagesë dhe Byrosë trajtuese. Kjo garanton përmbushjen e të gjitha detyrimeve që dalin nga anëtarësimi në sistemin e kartonit ndërkombëtarë të sigurimit.

Në funksion të kësaj, Byroja Kosovare e Sigurimit është përfaqësuese kombëtare në Këshillin e Byrove dhe ka përgjegjësi për të gjitha detyrimet që buronin nga anëtarësimi në sistemin e kartonit të gjelbër. Ajo kryen rolin e Fondit të Kompensimit për pagesën e dëmeve të parashikuara nga ky ligj dhe financohet nga Fondi i Kompensimit. Përmes Fondit të Kompensimit, Byroja Kosovare e Sigurimit ka përgjegjësinë për pagesën e dëmeve të shkaktuara nga aksidentet automobilistike që kanë ndodhur në territorin e Republikës së Kosovës dhe janë shkaktuar nga mjete të pasiguruara ose të paidentifikuara.

Personat e dëmtuar në aksidentet automobilistike brenda territorit të Republikës së Kosovës, të cilat janë shkaktuar nga mjetet e pasiguruar apo të paidentifikuara, kanë të drejtën e dëmshpërblimit nga Byroja Kosovare e Sigurimit, në veçanti nga Fondi i Kompensimit. Fondi i Kompensimit është një fond i dedikuar për këtë qëllim dhe është krijuar për të kompensuar personat e dëmtuar si pasojë e aksidenteve automobilistike të shkaktuara nga mjete motorike. Kompanitë e Sigurimit që janë anëtare të Byrosë Kosovare të Sigurimit dhe që ofrojnë sigurime detyrues nga autopërgjegjësia në territorin e Republikës së Kosovës janë të obliguara të kontribuojnë në Fondin e Kompensimit, duke bërë kontribute në përpjestim të drejtë me primet bruto të tyre.

Personat e dëmtuar nga aksidentet e komunikacionit, të cilat janë shkaktuar nga mjetet e paidentifikuara, duhet të paraqesin kërkesën për kompensim në Byrojën Kosovare të Sigurimit brenda një periudhe prej 90 ditësh nga data e aksidentit. Kjo është një pjesë e sistemit të sigurimit të detyrueshëm nga autopërgjegjësia në Kosovë dhe është krijuar për të mbrojtur të gjithë personat e dëmtuar në aksidentet automobilistike (Byroja Kosovare e Sigurimit).

---

## KAPITULLI I DYTË: KOMPANIA E SIGURIMIT – SIGURIA

---

### 2. Zanafilla e zhvillimit të Kompanisë së Sigurimit – Siguria

Kompania e Sigurimeve SIGURIA është një organizatë e themeluar në datën 5 qershor 2000, si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me ligjin për sigurimin e përkohshëm të shoqërive tregtare (UNMIK Reg. 2000/8, datë 29 shkurt 2000). Në periudhën e saj të hershme, kjo kompani nisi aktivitetin me sigurimet e njohura si të detyrueshme në tregun tonë, por shpejt solli një frymë të re në tregun e sigurimeve duke prezantuar produkte të reja vullnetare, në ngjashmëri me kompanitë evropiane të tjera.

Kompania e Sigurimeve SIGURIA ka punuar me përkushtim për të ofruar gamën më të gjerë të produkteve, me qëllim të krijuarjes së një sigurie maksimale për klientët e saj. Duke mbajtur një qëndrim të përgjegjshëm, kompania ka zbatuar me sukses të gjitha detyrimet financiare dhe ka respektuar ligjin për sigurime, i miratuar nga BQK (Banka Qëndrore e Kosovës), që është baza e të gjitha aktiviteteve të ardhshme. Portfolioja e sigurimeve është ristrukturuar duke përfshirë siguruesit më të besueshëm në treg, për të garantuar që të plotësojnë detyrimet ndaj klientëve. Sot, tregu i tyre mbulon tërë territorin e Kosovës dhe po eksploron mundësinë e zhvillimit të veprimtarisë jashtë kufijve të vendit.

Kompania e Sigurimeve SIGURIA ofron një gamë të gjërë të produkteve sigurimore dhe shërbimeve të tyre përmes një rrjeti të gjerë të stafit të shitjeve, agjentëve dhe partnerëve ekskluzivë në të gjithë territorin e Kosovës. Në momentin e tanishëm, kompania ka një staf prej rreth 80 punonjësve në zyrat e saj dhe rreth 150 agjentë që punojnë nën përkuqjesjen e "Kompanisë së Sigurimit SIGURIA." Angazhimi i tyre është për të siguruar që klientët të kenë një përvojë të përsosur në fushën e sigurimeve.

#### 2.1 Produktet të cilat ofrohen nga kompania

Sot, SIGURIA ofron një gamë të gjerë të produkteve sigurimore, duke përfshirë sigurimin e përgjegjësive ndaj palëve të treta për automjetet (TPL), si dhe sigurime vullnetare të tilla si:

- Sigurimi i dëmeve të automjeteve,

- Sigurimi nga aksidentet personale,
- Sigurimi i banesave dhe shtëpive,
- Sigurimi i pronës,
- Sigurimi i mallit në transport,
- Sigurimi i bankave,
- Sigurimi i parave në kasafortë dhe parave në transport,
- Sigurimi i përgjegjësisë publike, dhe shumë të tjera.

## 2.2 Objektivat e kompanisë

Kompania është vendosur në një pozicion të prerë në treg dhe ka ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm për të arritur qëllimet e saj strategjike:

- Një nga qëllimet kryesore është rritja e normës së fitimit bruto në krahasim me prime të grumbulluara. Ky hapi është bërë për të siguruar stabilitetin financiar të kompanisë dhe për të financuar zhvillimin e saj të ardhshëm.
- Kompania është përpjekur të rrisë të ardhurat e përfituara nga tregu i sigurimeve të detyrueshme dhe ka arritur të konkurojë në nivelin e kompanive kryesuese në këtë fushë. Kjo ka krijuar një pozicion më të fortë në treg dhe ka rritur reputacionin e saj.
- Si pjesë e strategjisë së saj, kompania ka synuar të bëhet një lider në fushën e sigurimeve vullnetare. Ky hapi ka shpërbërë kufijtë tradicionalë të tregut dhe ka ndihmuar në diversifikimin e ofertave të saj.
- Kompania ka vënë theks të veçantë në ofrimin e një shërbimi sa më cilësorë për klientët. Kjo përfshin modernizimin dhe përmirësimin e proceseve të shërbimit ndaj klientëve dhe sigurimin e një përvoje të përsosur për ta.


Rezultati i kësaj strategjie është që kompania ka arritur të marrë pjesë në tregun e sigurimeve me një përqindje të rëndësishme, rreth 25%, duke e konsideruar faktin se tregu është i ndarë në mesin e 8 kompanive të tjera të sigurimeve që operojnë në territorin e Kosovës. Kjo tregon suksesin dhe konkurrencën e suksesshme të kompanisë në tregun e sigurimeve ([Kompania e sigurimeve Siguria – Kompania e Sigurimeve Siguria \(ks-siguria.com\)](#)).

## 2.3 Treguesit e performancës

Suksesi i kompanisë SIGURIA matet me rritjen e numrit të klientëve të saj, i cili vazhdon të rritet me kalimin e kohës. Një aspekt i pashmangshëm i këtij rritjeje është edhe rritja e besimit të klientëve të kompanisë, çka ndihmon në përmirësimin e cilësisë së ofertave dhe të përgjegjësive që dalin nga sigurimet.

Besimi i klientëve në aftësitë e kompanisë për të përmbushur detyrimet e saj në çdo kohë është thelbi i suksesit të tyre. Dinamizmi është një karakteristikë kyç që përshkruan mënyrën se si Siguria trajton shërbimin ndaj klientëve. Kompania ka punuar me përkushtim për të përmirësuar efikasitetin dhe shpejtësinë e proceseve të klientëve, duke përfshirë modernizimin dhe optimizimin e të gjitha procedurave dhe duke ofruar shërbime të larta në cilësi. Kompania e Sigurimeve SIGURIA ka përfituar nga përkrahja e pakufishme e partnerëve të saj gjatë rrugës së saj të zhvillimit. Partnerët kanë luajtur një rol të rëndësishëm dhe pa tyre është e vështirë të arrihet niveli i suksesit që kompania ka arritur. Njohur për shërbimin e saj të lartë në fushën e sigurimeve, Kompania e Sigurimeve SIGURIA ofron një gamë të gjerë të produkteve për klientët e saj. Këto produkte vijnë në forma të ndryshme dhe klientët kanë mundësinë të zgjedhin ofertën që përshtatet më mirë me nevojat dhe kërkesat e tyre. SIGURIA synon të jetë një partner i besueshëm për klientët dhe ka qëllim të sigurojë mbulimin maksimal të tregut të sigurimeve. Kompania gjithashtu ka vizionin e vazhdueshëm për risi dhe inovacione të reja në fushën e sigurimeve.

Figura 1. Treguesit e kthimit në ROA dhe ROE



Burimi: Kompania e Sigurimeve - SIGURIA



## 2.4 Kompensimi i dëmeve

Një marrëveshje e vullnetshme midis dy ose më shumë palëve, që synon të legalizohet dhe zbatohet sipas ligjit, njihet si kontratë. Çdo palë paraqet një ofertë me kushtet e saj të veçanta, ndërsa pala tjetër e pranon atë ofertë duke pranuar të njëjtat kushte. Në sferën e sigurimeve, njëra palë ka detyrimin të paguajë një shumë të quajtur "prim" ose të premtojë këtë pagesë, ndërkohë që pala tjetër premtonte të kryejë dëmshpërblim në rrethanat e përcaktuara në marrëveshje. Këto dy palë të marrëveshjes sigurimi përbëjnë një kontratë sigurimi.

Kompensimi i dëmeve është një proces në të cilin një person ose një entitet i paguan një shumë të caktuar parash për të mbuluar humbjet ose dëmet që i janë shkaktuar dikujt tjetër. Në tabelën 1. shohim sa dëme ka kompensuar Kompania e Sigurimit – Siguria prej vitit 2016 deri në vitin 2022.

Në vitin 2016, prej 45,381 kontrata të lidhura që ka pasur, kjo kompani ka paguar 8,490 prej tyre me vlerë totale 3,023,396 EUR. Deri në vitin 2018 ka pësuar zvogëlim në numrin e kontratave prej nga pasqyrohet edhe zvogëlim i pagimeve të dëmeve, ndërkaq vitet e tjera ka pasur cdoherë rritje në numrin e kontratave të lidhura, ku në vitin 2022, ka pasur gjithsej 60,689 kontrata të lidhura, ku prej tyre janë paguar 5494 dëme me vlerë totale 3,938,935 EUR.

*Tabela 1. Kompensimi i dëmeve ndër vite*

<b>Vitet</b>	<b>Numri i kontratave</b>	<b>Dëmet e paguara</b>	<b>Shuma e paguar</b>
<b>2016</b>	45,381	8,490	3,023,396
<b>2017</b>	42,425	7,417	2,925,224
<b>2018</b>	38,702	5,342	3,200,899
<b>2019</b>	45,712	5,905	3,423,758
<b>2020</b>	46,108	5,091	3,986,626
<b>2021</b>	48,613	5,703	3,904,001
<b>2022</b>	60,689	5,494	3,938,935

Burimi: Kompania e Sigurimeve - SIGURIA

## 2.5 Struktura e kapitalit

Kompania “SIGURIA” në gjashtëmujorin e fundit ka pasur këtë strukturë kapitali e paraqitur në tabelën në vijim:

Tabela 2. Struktura e kapitalit e kompanisë SIGURIA

	31.03.2023	31.06.2023
<b>DETYRIMET</b>		
Provizionet për dëme dhe shpenzimet e trajtimit të dëmeve	11,292	11,430
Provizionet për primin e pa fituar dhe riskun e pa skaduar	4,440	4,845
Llogaritë e pagueshme të sigurimit dhe detyrimet tjera	1,575	1,532
Huatë dhe kreditë	41	-
Kreditorët tjerë dhe Akrualet	195	179
<b>GJITHSEJ DETYRIMET</b>	<b>17,543</b>	<b>17,986</b>
<b>KAPITALI AKSIONAR</b>		
Kapitali aksionar	18,203	18,203
Fitimi i akumuluar	-13,994	-13,892
Rezerva tjera	534	534
<b>GJITHSEJ KAPITALI AKSIONAR</b>	<b>4,742</b>	<b>4,845</b>
<b>GJITHSEJ DETYRIMET DHE KAPITALI</b>	<b>22,285</b>	<b>22,831</b>

Burimi: Kompania e sigurimeve SIGURIA

### 3. Metodologjia e analizës empirike

Analiza e regresionit është baza e analizës empirike dhe ka shërbyer për të testuar secilën prej hipotezave të paraqitura. Përdorimi i analizës së regresionit është një metodë statistikore e fuqishme që ka mundësuar zbulimin e ndikimeve të variablave të pavarura mbi variablat e përcaktuara, duke krijuar modele të ndryshëm të analizës së regresionit për secilën hipotezë. Rezultatet e analizave të regresionit janë interpretuar me kujdes për të vlerësuar madhësinë dhe drejtimin e ndikimeve të identifikuara. Kjo metodologji ka mundësuar arritjen e përfundimeve të lidhura me hipotezat dhe ka ofruar një përmbledhje të qartë të marrëdhënieve mes variablave të ndryshme të ndjekura në punim.

Kjo metodologji është përdorur për të kuptuar se si faktorë të ndryshëm ndikojnë në performancën financiare të Kompanisë së Sigurimeve - SIGURIA.

#### 3.1 Përshkrimi i të dhënave

Ky punim diplome vlerëson performancën e kompanisë së sigurimit SIGURIA përmes ndikimit të disa variablave të pavarura në dy variabla kryesore:

- 1) kthimi në asete (ROA) dhe
- 2) kthimi në ekuitet (ROE).

Kthimi në Asete (ROA): Vlerëson profitabilitetin në lidhje me fondet e investuara në kompani nga aksionerët e zakonshëm, aksionarët preferencialë dhe furnizuesit e financimit të borxhit. Kthimi në Kapital (ROE): Vlerëson profitabilitetin për shumën e investuar të pronarit (Warrad, 2015).

#### 3.2 Statistikat përshkruese

Në bazë të tabelës 3, fillimisht kemi variablat e varura prej nga shohim se vlera mesatare e kthimit në asete është -0.02 për qind me një devijim standard 0.11 për qind, vlerë minimale -0.23 për qind dhe vlerë maksimale 0.09 për qind. Treguesi tjetër, kthimi në ekuitet ka një vlerë mesatare 1.97 për qind me një devijim standard 5.29 për qind, me vlerë minimale -0.06 për qind dhe vlerë maksimale 13.92 për qind.

Më pas kemi variablat e pavarura në këtë analizë, ku vlera mesatare e raportit të dëmeve të ndodhura neto është -2.66 për qind me një devijim standard 0.65 për qind, vlerë minimale -0.95 për qind dhe vlerë maksimale 0.49 për qind. Raporti i shpenzimeve neto ka një vlerë mesatare -0.09 për qind me një devijim standard 1.48 për qind, vlerë minimale -1.64 për qind dhe vlerë maksimale 1.70 për qind.

Tutje, raporti i mbulueshmërisë së provizioneve teknike ka një vlerë mesatare 0.60 për qind me një devijim standard 0.13 për qind, me vlerë minimale 0.42 për qind dhe vlerë mesatare 0.77 për qind. Dhe në fund kemi edhe raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit, me vlerë mesatare 0.57 për qind, devijim standard 0.13 për qind, vlerë minimale 0.06 për qind dhe vlerë maksimale 1.28 për qind.

*Tabela 3. Statistikat përshkruese*

<b>Variablat</b>	<b>Obs</b>	<b>Mean</b>	<b>Std. Dev.</b>	<b>Min</b>	<b>Max</b>
ROA	7	-0.023	0.111	-0.226	0.093
ROE	7	1.972	5.290	-0.610	13.923
Raporti i dëmeve të ndodhura neto	7	-2.658	0.650	-0.955	0.497
Raporti i shpenzimeve neto	7	-0.087	1.480	-1.635	1.701
Raporti i mbulueshmërisë së provizioneve teknike	7	0.599	0.131	0.428	0.779
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	7	0.568	0.375	0.063	1.275

Burimi: Kalkulimet e autorit

### **3.3 Analiza e korrelacionit**

Matrica e korrelacioneve është dhënë në tabelën 3 dhe 4, ku në tabelën 3 shohim korrelacionin e variablës së varur kthimi në asete me variablat e tjera të pavarura, ndërsa në tabelën 4 shohim korrelacionin mes variablës kthimi në ekuitet dhe variablave të tjera.

Në tabelën 4, shohim se korrelacion pozitiv ekziston mes raportit të dëmeve të ndodhura neto dhe kthimit në asete, mes raportit të shpenzimeve neto me kthimin në asete dhe raportin e dëmeve të ndodhura neto, si dhe mes raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit me kthimin në asete dhe raportin e mbulueshmërisë së provizioneve teknike. Në anën tjetër, korrelacion negativ ekziston mes raportit të mbulueshmërisë së provizioneve teknike me kthimin në asete, raportin e dëmeve të ndodhura neto dhe raportin e shpenzimeve neto.

Tabela 4. Analiza e korrelacionit – ROA

	<b>ROA</b>	<b>RDNN</b>	<b>RSHN</b>	<b>RMPT</b>	<b>RMK</b>
<b>ROA</b>	1.000				
<b>RDNN</b>	0.606	1.000			
<b>RSHN</b>	0.764	0.966	1.000		
<b>RMPT</b>	-0.433	-0.006	-0.192	1.000	
<b>RMK</b>	0.334	-0.075	-0.689	0.170	1.000

Burimi: Kalkulimet e autorit

Sqarim: RDNN- raporti i dëmeve të ndodhura neto, RSHN – raporti i shpenzimeve neto, RMPT- raporti i mbulueshmërisë së provizioneve teknike, dhe RMK – raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit.

Në tabelën 5, kemi analizën e korrelacionit për kthimin në ekuitet, ku shohim se korrelacion pozitiv ekziston mes raportit të shpenzimeve neto dhe raportit të dëmeve të ndodhura, mes raportit të mbulueshmërisë së provizioneve teknike me kthimin në ekuitet, si dhe mes raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit me raportin e mbulueshmërisë së provizioneve teknike.

Ndërkaq, korrelacion negativ ekziston mes raportit të dëmeve të ndodhura neto me kthimin në ekuitet, mes raportit të shpenzimeve neto me kthimin në ekuitet, mes raportit të mbulueshmërisë së provizioneve teknike me raportin e dëmeve të ndodhura neto dhe raportin e shpenzimeve neto. Gjithashtu, korrelacion negativ ekziston edhe mes raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit me kthimin në ekuitet, raportin e dëmeve të ndodhura neto dhe raportin e shpenzimeve neto.

Tabela 5. Analiza e korrelacionit - ROE

	<b>ROE</b>	<b>RDNN</b>	<b>RSHN</b>	<b>RMPT</b>	<b>RMK</b>
<b>ROE</b>	1.000				
<b>RDNN</b>	-0.361	1.000			
<b>RSHN</b>	-0.498	0.966	1.000		
<b>RMPT</b>	0.199	-0.006	-0.192	1.000	
<b>RMK</b>	-0.580	-0.075	-0.068	0.170	1.000

Burimi: Kalkulimet e autorit

Sqarim: RDNN- raporti i dëmeve të ndodhura neto, RSHN – raporti i shpenzimeve neto, RMPT- raporti i mbulueshmërisë së provizioneve teknike, dhe RMK – raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit

### 3.4 Analiza e regresionit

Pas diskutimit të rezultateve mbi statistikat përshkruese, si dhe analizës së korrelacionit ndërmjet treguesve të përfshirë në analizë, në aspektin ekonometrik praktikohet të diskutohen disa teste mbi sa është modeli dhe qasja ekonometrike adekuate. Prandaj, bazuar në rezultatet e modelit kthimi në asete F-test ka rezultuar F (4,2) me probabilitet  $p = 0.0250$ , që nënkupton se të gjitha vlerat janë më të vogël se  $\alpha < 0.10$ .  $R^2$  në rastin e kthimit të aseteve është me koeficient 0.5874 ose 58.74 përqind. Kjo nënkupton se faktorët e analizuar e shpjegojnë 58.74 përqind të kthimit në asete në rastin e kompanisë së sigurimeve Siguria, ndërsa pjesa e mbetur shpjegohet nga variablat të cilët nuk janë përfshirë në analizë. Dhe testi Durbin Watson, i cili vlerësohet në bazë të intervaleve, 0 deri 1.5 korrelacion serial negativ, 1.5 deri në 2.5 nënkupton se vlera e mbetur nuk ka korrelacion serial ndërmjet vlerave të mbetura dhe mbi intervalin 2.5 të dhënat kanë korrelacion serial pozitiv. Të dhënat tona kanë një interval DW=2.016 që nënkupton se të dhënat tek modeli ekonometrik ROA nuk kanë një korrelacion serial mes vete.

Tabela 6. Analiza e regresionit – ROA

	ROA	Coefficient	Std. Err.	T	P>[t]	[ 95% Conf. Interval]	
Raporti i dëmeve të ndodhura neto		-0.34851	0.078	-4.46	0.047	-0.685	-0.012
Raporti i shpenzimeve neto		0.20779	0.035	5.94	0.027	0.057	0.358
Raporti i mbulueshmërisë së provizioneve teknike		0.02002	0.102	0.2	0.863	-0.419	0.459
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit		0.10892	0.024	4.45	0.047	0.004	0.214
_cons		-0.17112	0.073	-2.34	1.44	-0.486	0.143
F (4, 2)					39.3		
					p=0.0250		
R-squared					0.587		
Adj R-squared					0.462		
Durbin-Watson					2.016		

Burimi: Kalkulimet e autorit

Në bazë të modelit ekonometrik, të paraqitur në tabelën 6, shohim se raporti i dëmeve të ndodhura neto ka ndikim negativ në performancën (e vlerësuar përmes kthimit në asete) e kompanisë së sigurimit SIGURIA me vlerë koeficienti ( $\beta = -0.34851$ ) me nivel besueshmërie 95 për qind. Këto të gjeturat na japin indikacione se çdo rritje e raportit të dëmeve të ndodhura neto për një përqind, ndikon në zvogëlim të kthimit në asete prej 34.85 pikë përqindje. Në kundërshtim me këtë punim

kemi (Ke *et al.* 1999), sipas të cilëve ekziston një lidhje pozitive mes kompensimit të dëmeve dhe kthimit në asete.

Në anën tjetër, në rezultatet e mëposhtme shohim se ndikim pozitiv në performancën e kompanisë së sigurimit SIGURIA, kanë raporti i shpenzimeve neto me vlerë koeficienti ( $\beta=0.20779$ ) me nivel besueshmërie 95 për qind, prej nga kuptojmë se cdo rritje e shpenzimeve neto për një përqind ndikon në kthimin në asete 20.77 pikë përqindje. Raporti i mbulueshmërisë së provizioneve teknike me vlerë koeficienti ( $\beta=0.02002$ ) me nivel besueshmërie 90 për qind, na lë të kuptojmë se 1 për qind rritje në këtë raport, rrit për 2 pikë për qind kthimin në asete dhe në fund Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit me vlerë koeficienti ( $\beta=0.10892$ ) me nivel besueshmërie 95 për qind, nënkupton se me rritjen e këtij raporti, rritet edhe kthimi në asete për 10.89 pikë për qindje. Në përputhje me këto rezultate është (Khalaf & Nobanee, 2022), sipas të cilit qëndrueshmëria e një kompanie sigurimi ka ndikimin më të madh në performancën e saj.

Gjithashtu, bazuar në rezultatet e modelit kthimi në ekuitet F-test ka rezultuar F (4,2) me probabilitet  $\rho = 0.0508$ , që nënkupton se të gjitha vlerat janë më të vogël se  $\alpha < 0.10$ .  $R^2$  në rastin e kthimit në ekuitet është me koeficient 0.6968 ose 69.68 përqind. Kjo nënkupton se faktorët e analizuar e shpjegojnë 69.68 përqind të kthimit në asete në rastin e kompanisë së sigurimeve Siguria, ndërsa pjesa e mbetur shpjegohet nga variablat të cilët nuk janë përfshirë në analizë. Testi Durbin Watson, i cili vlerësohet në bazë të intervaleve, në rastin tonë ka një interval DW=3.2323 që nënkupton se këto të dhëna kanë një korrelacion serial mes vete.

*Tabela 7. Analiza e regresionit – ROE*

<b>ROE</b>	<b>Coefficient</b>	<b>Std. Err.</b>	<b>T</b>	<b>P&gt;[t]</b>	<b>[ 95% Conf. Interval]</b>	
Raporti i dëmeve të ndodhura neto	20.65186	12.161	1.70	0.032	-31.674	72.978
Raporti i shpenzimeve neto	-10.88455	5.435	-2.00	0.083	-34.269	12.499
Raporti i mbulueshmërisë së provizioneve teknike	-11.16181	15.875	-0.70	0.555	-79.467	57.144
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	-7.784941	3.807	-2.05	0.077	-24.163	8.593
_cons	17.62436	11.366	1.55	0.061	-31.133	66.527
F(4, 2)				3.22		
Prob > F				0.0508		
R-squared				0.6968		
Adj. R-squared				0.9351		
Durbin-Watson				3.23225		

*Burimi: Kalkulimet e autorit*

Tek tabela 7, kemi modelin ekonometrik mbi kthimin në ekuitet, ku raporti i dëmeve të ndodhura neto ka ndikim pozitiv në performancën e kompanisë së sigurimit SIGURIA me vlerë koeficienti ( $\beta=20.65186$ ) me nivel besueshmërie 95 për qind, që nënkupton se rritja e raportit të dëmeve të ndodhura neto, rrit 200 pikë për qind kthimin në ekuitet. Në përputhje me këtë punim është edhe (Duc Cuong Pham *et al.* 2021).

Në anën tjetër, shohim se variablat e tjera kanë ndikim negativ në performancën e kompanisë së sigurimit SIGURIA, raporti i shpenzimeve neto me vlerë koeficienti ( $\beta=-10.88455$ ) me nivel besueshmërie 95 për qind, ku 1 për qind rritje në këtë raport, zvogëlon kthimin në ekuitet për 100.88 pikë për qindje. Raporti i mbulueshmërisë së provizioneve teknike me vlerë koeficienti( $\beta=-11.16181$ ) me nivel besueshmërie 90 për qind, prej nga rritja e këtij raporti zvogëlon kthimin në ekuitet për 110.16 pikë për qind dhe në fund Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit me vlerë koeficienti ( $\beta=-7.78494$ ) me nivel besueshmërie 95 për qind nënkupton gjithashtu se cdo rritje e raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit ndikon në zvogëlimin e kthimit në ekuitet për 700.78 pikë për qindje. Punimi ynë ka përpuethshmëri me (Hossain & Uddin, 2021).



---

## *KAPITULLI I KATËR: KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME*

---

Si përfundim, kjo temë ka synuar të analizojë vlerësimin e performancës dhe kompenzimin e dëmeve në industrinë e sigurimeve duke marrë si analizë rasti Kompaninë “Siguria” për periudhën kohore 2016-2022. Në këtë punim përfshihen variablat (kthimi në asete, kthimi në ekuitet, raporti i dëmeve të ndodhura neto, raporti i shpenzimeve neto, raporti i mbulueshmërisë së provizioneve teknike dhe raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit) të dhëna sekondare këto, të mbledhura në webfaqen zyrtare të kompanisë së sigurimit – SIGURIA. Tutje këto të dhëna janë përpunuar përmes programit statistikor STATA, në kuadër të së cilit janë nxjerrë analizat (statistikat përshkruese, analiza e korrelacionit dhe analiza e regresionit).

Rezultatet e këtij studimi tregojnë se raporti i dëmeve të ndodhura neto dhe raporti i mbulueshmërisë së rezervave teknike kanë ndikime negative në kthimin në asete të kompanisë, përderisa raporti i shpenzimeve të përgjithshme neto ka një ndikim pozitiv në kthimin në asete. Ndërkaq, raporti i dëmeve të ndodhura neto dhe raporti i mbulueshmërisë së rezervave teknike kanë ndikime pozitive në kthimin në kapital, ndërsa raporti i shpenzimeve të përgjithshme neto ka një ndikim negativ në kthimin në kapital. Në kuadër të analizave janë bërë edhe testet diagnostifikuese të cilat vërtetojnë hipotezat e parashtruara në këtë punim.

Gjatë punimit të kësaj teme kam hasur edhe në disa kufizime, që përfshijnë kufizimet e të dhënave, kohës dhe burimeve. Mungesa e të dhënave të detajuara dhe të mëhershme për Kompaninë e Sigurimeve – SIGURIA mund të ketë limituar analizën. Përdorimi i një periudhe relativisht të shkurtër, nga viti 2016 deri në vitin 2022, ka mundësi të mos pasqyrojë ndryshimet afatgjate në performancën e kompanisë dhe mungesa e burimeve të mjaftueshme dhe qasja e dobët në të dhëna shtesë ose burime shtesë, mund të ketë bërë që analiza të mos jetë aq e thellë sa është planifikuar.

Për punimet e ardhshme në këtë fushe, sugjeroj të inkorporohet periudhë më e gjatë e serive kohore me të dhëna më të hollësishme, të aplikohen variabla të tjera që kanë të bëjnë me procesin e digjitalizimit për të nxjerrë rezultate më të detajuara.

## Rekomandime

Nisur nga konkludimet e konstatuara më lartë në këtë punim, synojmë të japim disa nga rekomandime specifike, dhe ato janë si në vijim:

- Përmirësimi i menaxhimit të dëmeve është i nevojshëm për të zvogëluar ndikimin negativ të tyre në raportin e kthimit të aseteve dhe raportin e kthimit të kapitalit.
- Konsolidimi i menaxhimit të provizioneve teknike për të rritur mbulueshmërinë e tyre dhe për të siguruar që janë në përputhje me dëmet potenciale.
- Përmirësimi i efikasitetit të menaxhimit të shpenzimeve në mënyrë që të zvogëlohen shpenzimet neto dhe të përmirësohet efikasiteti financiar.
- Rritja e kapitalit të disponueshëm në kompani për të mbuluar rreziqet potenciale dhe për të përmirësuar ndërlidhjen mes mjaftueshmërisë së kapitalit dhe raportit të kthimit të aseteve.
- Monitorimi me kujdes i strukturës së kapitalit dhe sigurimi që ka mjaftueshëm burime të disponueshme për të mbuluar nevojat e kompanisë.

## Referenca

- "BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS." Faqja zyrtare e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. <https://bqk-kos.org/>
- "Baza e të Dhënave për Sigurimet | Autoriteti i Sigurimeve të Kosovës." Autoriteti i Sigurimeve të Kosovës. <https://bks-ks.org/>
- "Kompania e Sigurimeve SIGURIA - Faqja Zyrtare." SIGURIA. <https://ks-siguria.com/siguria/>
- Berisha, Merita. "Tregu i Sigurimeve në Kosovë" (2014). Theses and Dissertations. 2383.
- Chowdhury, Yeaseen. (2015). Performance Analysis of General Insurance Companies: A Case Study on Bangladesh. BUP JOURNAL, Volume 1. 33.
- Duc Cuong Pham et al. (2021) The impact of sustainability practices on financial performance: empirical evidence from Sweden, Cogent Business & Management, 8:1, 1912526, DOI: 10.1080/23311975.2021.1912526
- Dwivedi, Rishi et al. (2021). Performance evaluation of an insurance company using an integrated Balanced Scorecard (BSC) and Best-Worst Method (BWM). Decision Making: Applications in Management and Engineering. 4. 33-50. 10.31181/dmame2104033d.
- Hossain, Mohammad & Uddin, Md. (2021). IMPACT OF OPERATING EXPENDITURES ON FIRMS' PROFITABILITY. Volume 11 Issue 4 (2020). 1.
- Ke et al. (1999). Ownership Concentration and Sensitivity of Executive Pay to Accounting Performance Measures: Evidence from Publicly and Privately-Held Insurance Companies. *Journal of Accounting & Economics*, Vol 28, No 2
- Khalaf, Khlaed & Nobanee, Haitham. (2022). Sustainability and Performance in Insurance Companies. *Researchgate*
- [LIGJI NR. 03/L-209 PËR BANKËN QENDRORE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS \(rks-gov.net\)](#)
- [LIGJI NR. 04/L-018 PËR SIGURIMIN E DETYRUESHËM NGA AUTOPËRGJEGJËSIA \(rks-gov.net\)](#)

[LIGJI NR. 04/L-093 PËR BANKAT INSTITUCIONET MIKROFINANCIARE DHE INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKARE \(rks-gov.net\)](#)

[LIGJI NR. 05/L -045 PËR SIGURIMET \(rks-gov.net\)](#)

Outreville, J.. (1998). Insurance and Economic Development. 10.1007/978-1-4615-6187-3\_2.

[RA 2001-25.PDF \(unmissions.org\)](#)

Ralph S. J. Koijen Motohiro Yogo (2021). THE EVOLUTION FROM LIFE INSURANCE TO FINANCIAL ENGINEERING. *National bureau of economic research*.

[RREGULLORE NR \(unmissions.org\)](#)

Warrad, Lina. (2015). Return on Asset and Return on Equity Effects of Net Operating Cycle: Jordanian Study. *Research Journal of Finance and Accounting*. 6. 89-95.